

# **STATUTI I SHOQËRISË**

**PJESA I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Ortakët Themelues**

1.1 Ortakët themelues të shoqërisë janë:

- Zj. Suela Zarka, shtetase shqiptare, lindur më 11.06.1981, madhore, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me numër I15611138W, me adresë Rr. “Shyqyri Brari”, Tiranë.
- Znj. Algerta Elezi, shtetase shqiptare, lindur më 07.10.1988, madhore, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me numër I86007052W, me adresë Rr. “Besim Daja”, Tiranë.
- Zj. Erza Askushaj, shtetase shqiptare, lindur më 10.12.1991, madhore, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me numër J16210064O, me adresë Rr. “Besim Daja”, Tiranë.

1.2 Sot më datë 07.12.2023 ortakët e shoqërisë vendosën themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emrin “City Lockers” sh.p.k..

**Neni 2**  
**Emri i Shoqërisë**

2.1 Emri i shoqërisë është “City Lockers” sh.p.k (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

**Neni 3**  
**Selia e Shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria ka selinë në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kulla Binjake 2, kati 1.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë degë, përfaqësi, zyra dhe njësi në çdo vend brenda Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, si dhe do të zbatojë procedurat përkatëse ligjore dhe të regjistrimit.
- 3.3 Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

**Neni 4**  
**Forma ligjore e Shoqërisë**

- 4.1 Forma ligjore e Shoqërisë është “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” (sh.p.k.) dhe e fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 4.2 Shoqëria është person juridik shqiptar e cila zhvillon aktivitetin sipas ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.



**Neni 5**  
**Kohëzgjatja**

- 5.1 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.
- 5.2 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë mund të përcaktohet një afat për përfundimin e veprimtarisë dhe prishjen e saj.

**Neni 6**  
**Objekti i Veprimtarisë**

- 6.1 Objekti i veprimtarisë konsiston në:
- a. Konceptimin, projektimin dhe zbatimin e sistemeve të ruajtjes së sendeve personale në shkallë të vogël (rafte) duke përfshirë anën fizike dhe softuerike të sistemeve objekt veprimtarie.
  - b. Ofrimin e shërbimit të ruajtjes së bagazheve të udhëtarëve nëpërmjet një zgjidhje të sigurtë dhe të besueshme për ruajtjen e sendeve personale.
  - c. Ofrimin e shërbimit të dhënies me qira të ambienteve magazinuese të vogla (rafte) kundrejt palëve të treta.
  - d. Ofrimin e çdo shërbimi tjetër që lidhet me aktivitetin bazë duke përfshirë por jo vetëm, shërbimet për sigurinë, shërbimet elektronike të rezervimit, pagesës etj.
- 6.2 Më tej, shoqëria mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm, i cili nuk lidhet drejtpërdrejtë me aktivitetin e Shoqërisë pa e përcaktuar atë me saktësi, duke ndjekur procedurat përkatëse për shtimin e objektit të veprimtarisë.

**PJESA II**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË DHE KUOTAT**

**Neni 7**  
**Kapitali i Shoqërisë**

- 7.1 Kapitali fillestar i shoqërisë është 3.000 (tre mijë) lekë.
- 7.2 Kapitali themeltar është i përbërë nga 3 (tre) kuota, me vlerë nominale prej 1.000 (një mijë) lekë secila.
- 7.3 Pjesëmarrja me kuota e ortakëve është si më poshtë:
- Zj. Suela Zarka zotëron 33.33% të të gjithë kuotave të shoqërisë, me vlerë nominale 1.000 (një mijë) lekë;
  - Znj. Algerta Elezi zotëron 33.33% të të gjithë kuotave të shoqërisë, me vlerë nominale 1.000 (një mijë) lekë;
  - Zj. Erza Askushaj zotëron 33.33% të të gjithë kuotave të shoqërisë, me vlerë nominale 1.000 (një mijë) lekë.



- 7.4 Pronësia mbi kuotat dhe veprimet me to, regjistrohen në regjistrin që shoqëria mban për këtë qëllim dhe që përmban detyrimisht të dhënat e mëposhtme:
- Emrin, mbiemrin, nr. e pasaportës dhe adresën e pronarit të kuotave;
  - Vlerën nominale dhe numrin e kuotave në pronësi;
  - Emrin, mbiemrin, nr. e pasaportës dhe adresën e pronarit të ri të kuotave në rast transferimi;
  - Të dhënat e kontratës me të cilën është kryer transferimi i pronësisë mbi kuotën.

**PJESA III**  
**STRUKTURAT DREJTUESE**  
**TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE**

**Neni 9**  
**Përgjegjësia e kufizuar**

- 9.1 Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së pashlyer të kapitalit të shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet që disponon.

**Neni 10**  
**Të drejtat e lidhura me çdo kuotë**

- 10.1 Çdo pjesë/kuotë e secilit ortak do t'i përgjigjet një votë koresponduese në mbledhjet e ortakëve, në përputhje me vlerën nominale të kësaj kuote, si dhe i jep ortakut zotërues (në të njëjtën masë) të drejtën për të marrë dividend në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast ndërprerjeje të aktivitetit apo falimentimit të Shoqërisë.

**Neni 11**  
**E drejta e pjesëmarrjes në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve**

- 11.1 Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendim-marrjen e Shoqërisë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve.
- 11.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë personalisht ose me prokurë, të informohet mbi çështjet e shoqërisë si dhe të inspektojë dhe kontrollojë librat, regjistrat dhe çdo dokument tjetër të Shoqërisë.

**Neni 12**  
**Detyrimet e Ortakëve**

- 12.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre për shkak të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë, nëse ftohen nëpërmjet procedurës së përcaktuar, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimtarisë së saj, si dhe të respektojnë vendimet e Asamblesë së ortakëve dhe organeve të tjera të shoqërisë, nëse

këto vendime janë marrë në mënyrën e duhur dhe në përmbushje të kompetencave e qëllimit të organit përkatës.

**PJESA IV**  
**ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

**Neni 13**  
**Të drejtat e Asamblesë së Ortakëve**

- 13.1 Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 13.2 Asambleja e Ortakëve përbehet nga të gjithë ortakët *(në rastin kur ka më shumë se një ortak dhe/ose nga një ortak i vetëm në rastin kur ka vetëm një të tillë)*.
- 13.3 Asambleja e Ortakëve, përveç sa parashikohet ne dispozita te veçanta të Ligjit apo Statutit, ushtron në mënyrë ekskluzive të drejtat dhe kompetencat e mëposhtme:
- a. ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - b. pranimin e ortakeve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
  - c. vendimin mbi përjashtimin e një ortaku në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;
  - d. të japë të drejta nënshkrimi dhe/ose mundësi zëvendësimi për aksionet në Shoqëri.
  - e. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar dhe/ose çdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencionit të dhënë nga ortakët;
  - f. bashkimin, ndarjen, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë;
  - g. blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
  - h. hapjen dhe mbylljen e degëve dhe përfaqësive;
  - i. miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të Shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit;
  - j. blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
  - k. marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e çdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
  - l. të vendosë për investimet;
  - m. të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie;
  - n. të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
  - o. të japë dhe të heqë (revokojë) prokura ose autorizime për të vepruar në emër të Shoqërisë.
  - p. të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e shërbimit me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të Shoqërisë.
  - q. të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose pagesat mbi largimin e administratorëve dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
  - r. të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
  - s. caktimin e auditorëve, eksperteve kontabël dhe likuiduesve;
  - t. miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin;
  - u. ngritjen e padive kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë apo ortakëve;
  - v. përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;

- x. përcaktimin e buxhetit vjetor;
- y. marrjen e huave në emër të Shoqërisë dhe vendosjen e kushteve të huasë duke përfshirë vendosjen e aseteve të luajtshme dhe te paluajtshme të shoqërisë si mjete për garantimin e huave në forme hipoteke, pengu, barre, etj.
- z. miratimin e çdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së ortakëve ne përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

13.4 Në çdo rast Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të vendosë mbi çdo çështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të Shoqërisë.

#### **Neni 14** **Vendimet e Asamblesë së Ortakëve**

14.1 Vendimet e renditura për sa i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë, merren me një shumicë më të lartë ose të barabartë me 2/3 e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

14.2 Në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve votimi është i hapur. Në raste të veçanta dhe për çështje të veçanta, një votimi mund të kryhet i fshehtë në përputhje me dispozitat ligjore.

#### **Neni 15** **Thirrja e Asamblesë së Ortakëve**

15.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga administratori/ët të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë, ose në çdo vend tjetër nëse përcaktohet ndryshe në njoftim.

15.2 Asambleja e Ortakëve do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratori/ët, njoftim i cili duhet t'i dërgohet ortakëve nëpërmjet një letre rekomande ose nëpërmjet postës elektronike jo më pak se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara datës së caktuar të mbledhjes. Ftesa e shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë.

15.3 Ftesa për mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve do të tregojë datën, kohën dhe vendin e takimit, si dhe çështjet e rendit të ditës. Në rastin e një asambleje të zakonshme të ortakëve do të përfshihen gjithashtu, pasqyrat financiare të shoqërisë dhe Raporti i Administrimit.

15.4 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qenë prezent, atëherë njoftimi do të konsiderohet i dërguar.

15.5 Nëse të gjithë ortakët janë prezent në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, atëherë vendimet mund të merren edhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër, nëse të gjithë ortakët prezent janë dakord për zhvillimin e saj, pavarësisht kësaj parregullsie.

5



**Neni 16**  
**Vendimet e marra në Asamblesë e Ortakëve**

- 16.1 Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime edhe në mungesë të ortakëve nëse ky i fundit përfaqësohet me prokurë.
- 16.2 Në rastet e përfaqësimit me prokurë, ajo duhet të jetë me shkrim dhe e noterizuar, si dhe të paraqitet në mbledhjen e ortakëve. Në çdo rast, të dhënat kryesore të prokurës, përfshirë edhe tagrat e përfaqësimit, fiksohen në procesverbalin e mbledhjes. Prokura do të jetë e vlefshme vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Ortakëve.
- 16.3 Çdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, të cilët do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 16.4 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve mund të merren edhe pa pjesëmarrjen fizike të ortakëve, por në këto raste duhet të aplikohet një nga format e komunikimit virtual në kohë reale, sikurse janë, por pa u kufizuar vetëm në to, telekonferenca, video konferenca, komunikimi virtual dhe të tjera mënyra të ngjashme, nëse të gjithë ortakët kanë dhënë pëlqimin e tyre paraprak në fillimin e mbledhjes dhe identiteti i ortakëve mund të përcaktohet pa dyshim. Në rast të aplikimit të kësaj dispozite, forma dhe mjetet e komunikimit, qëndrueshmëria e tij gjatë mbledhjes, si dhe çdo defekt i mundshëm, duhet të përfshihen në procesverbalin e mbledhjes.

**Neni 17**  
**Drejtimi i mbledhjes së Asamblesë e Ortakëve**

- 17.1 Mbledhja e Asamblesë si rregull drejtohet nga njëri prej ortakëve i cili merr rolin e Kryetarit të Mbledhjes.
- 17.2 Në rast thirrjeje të mbledhjes së Asamblesë nga Administratori ose likuiduesi/it, ajo drejtohet nga personi ose njëri prej personave që kanë thirrur mbledhjen.
- 17.3 Në fillim të mbledhjes verifikohet pjesëmarrja e ortakëve sipas njoftimeve të kryera.
- 17.4 Mbledhja e Asamblesë zhvillohet mbi bazën e rendit të ditës së njoftuar.
- 17.5 Çdo çështje e rendit të ditës pasi shqyrtohet hidhet në votim. Për marrjen e vendimeve të vlefshme, aplikohen dispozitat përkatëse ligjore që rregullojnë kuorumin e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes në mbledhje.
- 17.6 Mbledhja e Asamblesë mund të marrë në shqyrtim dhe të vendosë për çështje të tjera jashtë rendit të ditës, me kusht që të jenë të pranishëm apo të përfaqësuar 100% e ortakëve, si dhe të gjithë ortakët të japin pëlqimin e tyre.



**Neni 18**  
**Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë se Ortakëve**


- 18.1 Për çdo mbledhje të ortakëve do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të përmbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për shoqërinë, një për regjistrin tregtar dhe një për secilin ortak. Procesverbalit i bashkëngjitet edhe lista e pjesëmarrësve në mbledhje së bashku me aktin e thirrjes së Asamblesë së Ortakëve.
- 18.2 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari edhe nga ortaket e tjerë pjesëmarrës.
- 18.3 Të gjitha vendimet e asamblesë se përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
- 18.4 Administratori është përgjegjës për mbajtjen e rregullt të procesverbaleve të mbledhjes, ruajtjen e kopjeve të rij dhe vënien në dispozicion të personave të interesuar, sipas ligjit.

**PJESA V**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**Neni 19**  
**Administrimi i Shoqërisë**

- 19.1 Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga një administrator, i cili do të përfaqësojë Shoqërinë individualisht. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që administrimi i shoqërisë mund të kryhet nga një ose më shumë administratorë.
- 19.2 Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare me mundësi rizgjedhje është:
- Znj. Algerta Elezi, lindur më 07.10.1988, madhore, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me numër I86007052W, me adresë Rr. "Besim Daja", Tiranë.
- 19.3 Administratori mund të autorizojë palë të treta që ta përfaqësojnë atë në transaksione të veçanta.
- 19.4 Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojë shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me objektin e aktivitetit të saj.
- 19.5 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Ortakëve. Administratori që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat

7



e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblenë e Ortakëve për emërimin e Administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja hyn në fuqi.

19.6 Duke marre parasysh kufizimet e Nenit 13 më sipër, administratori ka të drejtat e mëposhtme:

- a. Është i autorizuar të përfaqësojë shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të, kundrejt palëve të treta dhe me shtetin;
- b. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë pranë bankave brenda dhe jashtë vendit;
- c. lëshimi dhe marrja e urdhër-pagesave;
- d. nënshkrimin e të gjithë akteve financiare, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhe të huaja, flete-ngarkesat etj., pagimin e detyrimeve të Shoqërisë;
- e. veprimet bankare të shoqërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në to, hapjen dhe mbajtjen e llogarive bankare, transfertat bankare, tërheqjen e shumave që lidhen me aktivitetin e Shoqërisë.
- f. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë Shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
- g. dhënien e njoftimit të debitorëve të Shoqërisë;
- h. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse diçka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i Asamblesë së përgjithshme
- i. punësimin dhe shkarkimin e personelit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të tij;
- j. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj;
- k. udhëzimin e avokatëve/ juristëve për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë dhe përcaktimin e shumës së shpërblimit të tyre.
- l. ngritjen e padive dhe tërheqjen e tyre, nënshkrimin e marrëveshjeve gjyqësore, nënshkrimin e marrëveshjeve të arbitrazhit, caktimin e arbitrave;
- m. Administratori ka të drejtë të marre çdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti
- n. është përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin;
- o. thirrjen e Asamblesë së përgjithshme, përcaktimin e rendit të ditës, monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e Asamblesë së përgjithshme për shpalljen e vendimeve të veçanta;
- p. publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- q. është përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- r. marrë vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme, përveç atyre që u janë dhënë Asamblesë së Përgjithshme nga ky statut ose ligji.



**PJESA VI**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI, ADMINISTRIMI I FITIMIT**

**Neni 20**  
**Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare**

- 20.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit të po atij viti kalendarik.
- 20.2 Në fund të çdo viti financiar, Administratori do të përmbushë detyrat e mëposhtme:
- a. përgatitjen e një liste të detajuar të asetëve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
  - b. përgatitjen e pasqyrave financiare të shoqërisë si dhe shpjegimeve përkatëse;
  - c. të sigurojë përgatitjen e raportit të ecurisë së aktivitetit për vitin financiar.
  - d. të paraqesë për miratim nga Asambleja e Ortakëve, brenda datës 30 Qershor të çdo viti, pasqyrat financiare dhe/ose raportin e ecurisë së aktivitetit për vitin paraardhës.

**Neni 21**  
**Fitimi i Shoqërisë**

- 21.1 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat financiare vjetore të miratuara pas zbritjes së të gjitha detyrimeve tatimore dhe caktimit të rezervave ligjore. Pasqyrat financiare të shoqërisë do të miratohen nga Asambleja e Ortakëve dhe do të dorëzohen në organet tatimore sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

**PJESA VII**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

**Neni 22**  
**Prishja dhe likuidimi**

- 22.1 Shoqëria do të priset në rastet e mëposhtme:
- a. me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së asetëve për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
  - b. në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, sipas përcaktimeve në ligj;
  - c. në bazë të një vendimi të mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve;
  - d. në rast të bashkimit me një shoqëri tjetër;
  - e. në bazë të një vendimi të formës së prerë të gjykatës kompetente;
  - f. në të gjitha rastet e tjera të parashikuara në ligj.
- 22.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e asetëve të Shoqërisë do të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore.



**PJESA VIII  
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 23**

**Legjislacioni i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

23.1 Në rast të mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, Ortakët do përpiqen ti zgjidhin ato miqësisht. Në rast të kundërt, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksionin përkatës.

23.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.

23.3 Ky statut hartohet në 3 (tre) kopje origjinale.

*Miratohet sot më datë 11/12/2023 dhe nënshkruhet nga ortakët:*

**ORTAKËT THEMELUES**

**Zj. Suela Zarka**



**Znj. Algerta Elezi**



**Zj. Erza Askushaj**

